



Titulli i projektit: Mobilizimi i grave për zhvillimin e komunitetit

Financuar nga: Olof Palme International Center

Periudha e zbatimit: Januar 2012- Dhjetor 2015

Projekti zbatohet nga Qendra Aulona në Vlore, degë e QSHPZH

Qëllimi: Të varferit dhe të nënpërfaqësuarit, veçanërisht gratë, do të kenë një influence më të madhe mbi vendimet dhe politikat që afektojnë jetët e tyre.

I- Objektivat:

- 1- Të rriten kapacitetet e autoriteteve vendore për të ofruar shërbime që adresojnë nevojat specifike dhe interesat e grave dhe burrave në komunitet, gjë e cila do të sjellë zhvillime ekonomike, plane zhvillimi dhe alokim të burimeve.**
- 2- Të promovohet zëri i të varferve dhe qytetarëve të nënperfaqësuar, veçanërisht grave, me qëllim që të rritet transparenca e pushtetit vendor, përgjegjshmëria dhe reagimi ndaj qytetarëve.**
- 3 – Të rritet angazhimi i të gjithë aktorëve veçanërisht grupeve të grave, OJQve dhe partive politike për të vendosur bashkëpunim të vazhdueshëm midis tyre dhe për të ndikuar axhendat politike dhe vendimet e pushtetit vendor në favor të qytetarëve dhe për të mobilizuar qytetarët veçanërisht gratë si votuese në zgjedhjet lokale dhe kombëtare.**

II- Aktivitete

- 1. Aktivitete për Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen Vendore (6 diskutime në grupe të fokusuar me komunitetin, 6 diskutime në grupe të fokusuar me pushtetarët vendorë dhe tre debate ballafaqese midis komunitetit dhe**

- zyrtarëve vendorë.)
2. Monitorim i aktiviteteve të komunave/bashkisë si dhe këshillave përkatës të lidhura me rekomandimet nga rezultatet e studimeve si dhe forumet e grave.
 3. Mbledhje të Komisionit Këshillimor për buxhetimin me pjesëmarrje.
 4. Forumet e Grave
 5. Trainimi i grave aktiviste “Politikanet e reja”.
 6. Seminare mbi ligjin për barazinë gjinore, ligjin kundër dhunës në familjë, kodin elektoral dhe përfaqesuesit në pushtetin vendor.
 7. Panairi i turizmit familiar në Orikum mbi kuzhinën tradicionale dhe punimet artizanale.
 8. Programe në TV lokal për të dokumentuar modelet më të mira të grave si dhe për të prezantuar shqetësimet dhe sfidat e gruas.
 9. Takime dhe aktivitete të përbashkëta me OJQtë anëtare të koalicionit për “Nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në politikë”
 10. Takime me partitë politike.
 11. Konferencë mbi rezultatet e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen Vendore.
 12. Pasqyrim në faqen web të ACPD të aktiviteteve të projektit.
 13. Gazetë elektronike.

Rezultate të aktiviteteve për vitin 2014

1. **Aktivitete për Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen Vendore (6 diskutime në grupe të fokusuar me komunitetin, 6 diskutime në grupe të fokusuar me pushtetarët vendorë dhe tre debate ballafaqese midis komunitetit dhe zyrtarëve vendorë.)**
 6 diskutimet me komunitetin bënë vlerësimin me pikë të shërbimeve të ofruara nga pushteti vendor duke votuar edhe për nevojat më prioritare. Diskutimet në fokus grupe me pushtetarë lokalë sollën si rezultat vetëvlerësimin e 60 pushtetarëve vendorë mbi shërbimet që ata ofrojnë si dhe ndihmuan për hartimin e nje plani veprimi për përmirësimin aty ku ishte e mundur. Janë hartuar tre plane veprimi midis komunitetit dhe pushtetarëve vendorë për të adresuar disa nevoja prioritare, që do të monitorohen gjatë vitit 2015.
1. **Monitorim i aktiviteteve të komunave/bashkisë si dhe këshillave përkatës të lidhura me rekomandimet nga rezultatet e studimeve si dhe forumet e grave.**
15 gra anëtare të Forumeve të Pavarura të Grave në të tre zonat e zbatimit të projektit, kanë monitoruar nëntë mbledhje të këshillave të komunave/bashkisë, duke advokuar për çështjet më prioritare të identifikuar nga forumet e grave duke përmirësuar kështu dukshëm komunikimin midis pushtetit vendor dhe komunitetit.

2. Mbledhje të Komisionit Këshillimor për buxhetimin me pjesëmarrje. Tre Komisione Këshillimore janë ngritur në të tre zonat (Qendër, Novoselë, Orikum). Gjatë vitit 2014, 69 qytetarë kanë marrë pjesë në këto komisione duke bërë priorizimin e nevojave të komunitetit. 6 letra zyrtare janë dërguar tek qeveritarët vendore mbi nevoja që duhen përmbushur gjatë vitit në vazhdim, nevoja të pasqyruara edhe në Planin e Veprimit të hartuar gjatë Takimeve të Hapura. 57 anëtarë të Komisioneve Këshillimore janë trainuar dhe kanë marrë njohuri mbi buxhetimin me pjesëmarrje dhe buxhetimin gjinor.

3. Forumet e Grave

64 qytetare kanë marrë pjesë në nëntë takime të rregullta të forumeve të grave në të tre zonat e projektit, duke ngritur zërin për nevojat e tyre dhe duke u angazhuar në procesin e zhvillimit të komuniteteve përkatëse. Përveç kësaj forumet e grave mbledhen edhe për të organizuar aktivitete ndërgjegjësimi të ndërmarra nga ato vetë, si Dita e pastrimit, Çelja e sezonit Turistik, marshime për të drejtat e grave, përfaqësime në panaire të ndryshme etj.

Grate e forumeve janë përfshirë gjithashtu në informimin e publikut mbi mbledhjet e këshillave, duke advokuar dhe lobuar sistematikisht për nevojat prioritare pranë pushtetit vendor. Nga ana tjetër vihet re edhe një rritje e pjesëmarrjes së punonjësve të pushtetit vendor në mbledhjet e forumeve të grave.

4. Trainimi i grave aktiviste “Politikanet e Reja”

20 gra, aktiviste të partive politike si dhe të komuniteteve ku po zbatohet projekti, që morën pjesë në trainimin katër ditor në Maj 2014, fituan njohuri mbi pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e gruas në strukturat vendimarrëse, mekanizmat që rregullojnë pjesëmarrjen e gruas në vendimarrjen lokale, planifikimi dhe organizimi i fushatës elektorale, komunikimi me publikun dhe mediat, buxheti me pjesëmarrje dhe ai gjinor etj.

5. Seminare mbi ligjin për barazinë gjinore, ligjin kundër dhunës në familje, kodin elektorale dhe përfaqësuesit në pushtetin vendor

137 qytetare, që morën pjesë në **gjashtë seminare** (në të tre zonat e projektit), u informuan mbi barazinë gjinore, ligjin kundër dhunës në familjes, kodin zgjedhor, dhe u ndërgjegjësuat mbi nevojën për më shumë gra në vendimarrje.

6. Panairi i turizmit familiar në Orikum mbi kuzhinën tradicionale dhe punimet artizanale.

49 gra anetare të Forumit të Pavarur të Orikumit planifikuan dhe organizuan panairin dyditor, me gatime tradicionale, punime artizanale për promovimin e turizmit familiar në këtë zone. Rreth 3000 njerez (burra dhe gra) vizituan panarin. Aktiviteti u transmetua në lajmet e TV lokale.

7. Programe në TV lokal për të dokumentuar modelet më të mira të grave si dhe për të prezantuar shqetësimet dhe sfidat e gruas

Është vlerësuar se dy programet në TV janë ndjekur prej së paku 20000 vetë, me rastin e 8 marsit si dhe 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me baëe gjinore.

Gjashte anëtare të forumeve të grave në të tre zonat e projektit kanë marrë pjesë si protagoniste në keto programe, duke ndare sfidat dhe arritjet e tyre si pjesë e vendimarrjes në komunitetet përkatëse.

8. Takime dhe aktivitete të përbashkëta me OJQtë anëtare të koalicionit për “Nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në politikë”

ACPD me mbështetjen e koalicionit “për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në politikë”, me rastin e 8 Marsit si dhe 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore kanë realizuar një sërë fushatash advokacie në Tiranë dhe Vlorë me sloganin: “Barazia Gjinore në Politike nuk është në shitje” dhe “partitë politike duhet të mbajnë premtimet e tyre” Përveç këtyre marshimeve të përbashkëta janë realizuar edhe disa takime lobuese për çështjen e përfaqësimit të grave në vendimmarrje me drejtues të lartë të partive politike.

9. Takime me partitë politike.

45 përfaqësues të partive politike janë vënë në dijeni të shqetësimeve të grave, vecanërisht të nevojës për të rritur pjesëmarrjen e tyre në politike dhe vendimmarrje.

10. Konferencë mbi rezultatet e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen Vendore.

Zyrtarë të pushtetit vendor si dhe anëtarë të komunitetit të tre komunave kanë marrë pjesë në Konferencën ku u ndanë rezultatet dhe rekomandimet e studimit Vlerësim i komunitetit për qeverisjen vendore. Konferenca ndihmoi qytetarët dhe pushtetarët të kuptojnë arritjet dhe sfidat e ofruesve të shërbimeve në të tre zonat e projektit, të mesojnë nga eksperiencat e njëri tjetrit dhe të diskutojnë mbi mundësitë e mundshme të zgjidhjes së problematikave të përbashkëta.

Disa rezultate të studimit mbi Vlerësimin e komunitetit për Qeverisjen Vendore (VKQV) janë:

- forcoi mekanizmin e dialogut midis qytetarëve dhe autoriteteve lokale në Orikum, Novoselë dhe komunën Qender përmes tre takimeve të hapura ballafaqesë.
- adresoi nevojat prioritare të qytetarëve të zonës tek zyrtarët lokalë përmes identifikimit të nevojave prioritare dhe rekomandimeve për zgjidhje në të ardhmen.
- shërbeu si një mjet advokacie për përfshirjen e nevojave prioritare të grave në planet e bashkisë/komunës.
- shërbeu për të advokuar për përdorimin e kësaj metodologjie në vazhdimësi (VKQV) si një mjet për dialog, bashkëpunim dhe ndërveprim midis qytetarëve dhe pushtetit vendor.
- mobilizoi qytetarët të jenë pjesë e procesve vendimarrëse dhe të shprehin

problemet/çështjet e tyre, duke sugjeruar edhe zgjidhje për to.

- ndërgjegjësoi autoritetet vendore për të marre në konsiderate nevojat e qytetareve gjate hartimit te politikave lokale.

- prezantoi rezultatet e vleresimit te komunitetit ndaj pushtetit vendor ne nje takim te hapur, qe do te pasohet nga takime te tjera me kandidatet per zgjedhjet lokale.

- prezantoi zgjidhjet e propozuara, qe erdhen nga konsultimet midis qytetareve dhe pushtetareve vendore, per nevojat e cdo zone te projektit.

- publikoi nevojat prioritare të grave dhe Planet e veprimit të hartuara në secilën nga tre zonat e projektit.

- konferenca ndihmoi të promovonte metodologjine VKQV dhe rezultatet e saj në publik.

Më shumë foto mund ti gjeni nëse na vizitoni në faqen tonë në facebook:

<https://www.facebook.com/qendra.aulona>



Foto nga aktiviteti I Forunit te Grave Orikum me rastin e 8 marsit 2014.



Foto nga Debatimi I Hapur Orikum, komuna Qender dhe Novosele per VKQ



Foto nga Panairi dyditor I turizmit familiar Orikum 2014



Fokus grupe me punonjes te pushtetit vendor ne komunen Qender, Novosele dhe Orikum



Fokus grupe me komunitetin per vleresimin e komunitetit per qeverisjen vendor.



Foto nga workshopet në komunën Qendër, Novoselë dhe bashkinë Orikum.